



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik ▾Drejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾Donacione ▾Policimi në Komunitet
- Përmbledhja Mujore ▾Për sinjalizimin ▾Të Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Durrës/Shkaktoi aksident, me automjetin që drejtonte në gjendje të dehur, ndërkohë që ishte në kërkim, i dënuar me burgim, ndalohet 32-vjeçari



24/12/2025

Shkodër/Sekuestrohen 44 Kutë Me Lëndë Piroteknike Që U Gjetën Në Një Dyqan

Shkodër/Vijojnë kontrollet në zbatim të planit të masave për ndalimin e tregtimit të kundërligjshëm të lëndëve piroteknike, në prag të festave të fundvitit.

Sekuestrohen 44 kuti me lëndë piroteknike që u gjetën gjatë kontrollit në një dyqan në qytetin e Shkodrës.

Procedohet penalisht pronarja e dyqanit.

Si rezultat i kontrolleve intensive që po kryhen nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, në zbatim të planit të masave për ndalimin e tregtimit të kundërligjshëm të lëndëve piroteknike, nga subjekte të paautorizuara, në prag të festave të fundvitit, është goditur një rast i shitjes së këtyre lëndëve, në një dyqan në lagjen “Tre Heronjtë”.

Gjatë kontrollit në dyqanin e shtetases S. P. u gjetën 44 kuti me lëndë piroteknike (kapsolla), të ndaluara për tregtim, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen S. P.

Kontrollet për parandalimin e tregtimit të kundërligjshëm të lëndëve piroteknike do të vijojnë në të gjithë qarkun.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Shkodrës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Shkodër/Zbulohet një banesë e përshtatur për kultivimin e bimëve narkotike, me llamba

Vlorë/Vijojnë takimet informuese dhe sensibilizuese me nxënësit e shkollave ▶